



Pranimi / Dorezimi Prilaps / Prilaps Received / Delivery	11. 01	2024	4	Viti Year
Organ / Qësia Organ / District Org / Dist	SKIMSHK	216/2024		Sasia Kopësia Quantity
				114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1413/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ma. sored Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtar, dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1413/2023 të datës 14.11.2023, të parashtruar nga ankuesi _____ nga Prishtina, kundër organit të punësimit Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 11.01.2024 mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij Vendimi të nxjerrë akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 15.09.2023 të parashtruar nga ankuesi _____,

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë Vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 16.12.2023 në pozitën e punës „Zyrtar i lartë i personelit“ në Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, më datë 06.01.2023 përmes Vendimit me numër protokolli 400-21 të Zëvendës Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me caktimin e zyrtareve përgjegjës për çështje financiare është caktuar si „Zëvendësues i Zyrtarit Kryesorë Financiar“ për periudhën nga data 06.01.2023 deri më datën 31.12.2023, ne rastet kur mungon Zyrtari Kryesor Financiar .

Ankuesi në bazë të këtij Vendimit të lartpërmendur nga date 24.07.2023 deri me date 31.08.2023

e ka zëvendësuar Udhëheqësen e Divizionit për Buxhet dhe Financa respektivisht *Zyrtarin Kryesorë Financiar*.

Ankuesi më datë 15.09.2023 përmes e-mailit zyrtarë ka parashtruar kërkesë në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Pushtetit Lokal, lidhur me kompensimin në pagë për muajin gusht 2023 me rastin Zëvendësimit të Zyrtarit Kryesor Financiar sipas Vendimit me numër protokoll 400-21 të datës 06.01.2023. Ndërsa Divizioni për Burime Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk i ka kthyer asnjë përgjigje ankuesit.

Ankuesi për shkak të mos përgjigjes nga ana e organit të punësimit/Divizioni për Burime Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, më datë 14.11.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmsnck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin në vlerën (173.25) euro për shkak se nga data 26.07.2023 e deri më datë 31.08.2023 ka qenë Zëvendësues i Zyrtarit Kryesor Financiar, i njëjti për periudhën gjashtë (6) ditore të muajit korrik është kompensuar sipas Vendimit me numër protokoll 400-21 të datës 06.01.2023, ndërsa për muajin gusht nuk është kompensuar edhe për kundër faktit se më datë 15.09.2023 ka parashtruar ankesë pranë Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 29.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa Këshilli me datën 04.12.2023 ka pranuar përgjigje nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me shifër: VK/2023 të datës 26.12.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1413/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6977/2023 të parashtruar nga ankuesi më datë 14.11.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoll 400-21 të datës 06.01.2023 të lëshuar nga Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Pushtetit Lokal; Kërkesën e datës 15.09.2023 nga B.P për M.SH; Certifikatën me numër Nr.183/2022 të datës 19.09.2022; Listën e pagave për muajin Qershor 2023; Kërkesën për pagesë retroaktive të datës 10.08.2023; Kërkesën për aktivizim me numër 030-33/8 të datës 24.07.2023; Emërtimin dhe Fletë deponimin e Nënshkrimeve të datës 24.07.2023; Urdhër Obligimin për pagesë me numër 2023-135192 të datës 01.08.2023; Urdhër Obligimin për pagesë me numër 2023-135460 të datës 02.08.2023; Urdhër Obligimin për pagesë me numër 2023-202299 të datës 04.08.2023; Urdhër Obligimin për pagesë me numër 2023-204335 të datës 10.08.2023; Urdhër Obligimin për pagesë me numër 2023-230367 të datës 18.08.2023; Urdhër Obligimin për pagesë me numër 2023-236754 të datës 23.08.2023; Urdhër Obligimin për pagesë me numër 2023-249717 të datës 06.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.11.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 04.12.2023; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 25.09.2023; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 16.12.2023; Listën e pagave për muajin gusht 2023; Vendimin me shifër VK/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1.4 të Ligjit 06/L-048, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke obliguar organin e punësimit, që ti ndër marr të gjitha veprimet, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datës 15.09.2023, të parashtruar përmes e-mailit zyrtar nga nëpunësi civil

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i provave materiale ka konstatuar se, ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku sipas ndryshimit dhe plotësimit të aktit të emërimit më datë 16.12.2018 nga Zyrtarë për Logjistikë është emëruar në pozitën e punës Zyrtarë i Lartë i Personelit në kuadër të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, ndërsa sipas Vendimit me numër protokollit Nr.400-21 të datës 06.01.2023 të nxjerrë nga Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, është caktuar si Zëvendësues i Zyrtarit Kryesor Financiar për periudhën nga data 06.01.2023 deri më datën 31.12.2023, ne rastet kur mungon Zyrtari Kryesor Financiar .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjithashtu ka konstatuar se ankuesi më datë 15.09.2023 përmes emailit zyrtar ka parashtruar kërkesë pranë Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal duke kërkuar kompensimin në pagë për muajin gusht 2023 me rastin e zëvendësimit të Udhëheqëses së Divizionit për Buxhet dhe Financa respektivisht Zyrtarit Kryesorë Financiar sipas Vendimit me numër Nr.400-21 të datës 06.01.2023 të Zëvendës Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Pushtetit Lokal .

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit, Kolegji i Këshillit i'u referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht dispozitave të nenit 83 me të cilin përcaktohet se: „Procedura administrative fillon sipas kërkesës së palës apo sipas detyrës zyrtare nga organi publik”, ndërsa me nenin 97 paragrafi 1 parashihet se: „Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative”, si dhe nenin 98 ku thuhet se: „Procedura administrative nisur sipas kërkesës së palës, do të përfundoj sa më shpejtë që të jetë e mundur por jo më vonë se afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure”. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj. Nëse me ligj parashihet detyrimi i palës për të parashtruar një dokument apo për të kryer një veprim procedural, si pjesë apo së bashku me parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës, afati i përcaktuar në pajtim me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, do të filloj të llogaritet nga parashtrimi i dokumentit apo kryerja e veprimit procedural përkatës”. Andaj mbi këtë bazë ligjore, e duke qenë se organ i punësimit në këtë raste Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, nuk e ka shqyrtuar kërkesën e ankuesit të datës 15.09.2023, rrjedhë detyrimi që Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Pushtetit Lokal që brenda afatit si në dispozitiv të këtij Vendimi, të shqyrtoj kërkesën e ankuesit te datës 15.09.2023 të parashtruar përmes e-mailit zyrtar dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe të njëjtit t'ia komunikoj palës ankuese, ashtu siç përcaktohet me nenin 118 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



Theksuar si më sipër, e në kuptim të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e Kryetares të Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1413/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

[Signature]
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

